

V E N D I M

Nr. 11 Datë 25.01.2008


PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE NR.100, DATË 27.12.2006 “RREGULLAT DHE
PROCEDURAT E SHKËMBIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma l, dhe nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, nenit 12, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 100, datë 27.12. 2006 " Rregullat dhe Proçedurat e Shkëmbimit të Energjisë Elektrike", Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 25.01.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "KESH" sh.a për ndryshime dhe shtesa në "Rregullat e Proçedurave të Shkëmbimit të Energjisë Elektrike"

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregullat e Proçedurave të Shkëmbimit të Energjisë Elektrike si më poshtë:
 - Në nenin 3, pika 3, shtohet në fund të fjalisë së parë përmbajtja:
si dhe në rastet e avarive në sistemin e transmetimit.
 - Në nenin 3, pika 7, pas fjalës **Fax** shtohet fjala **E-mail**
 - Në nenin 4, në paragrafin ku shprehet "**në programin vjetor**" shtohet fjala **të miratuar**



➤ Në nenin 7 (Kërkesa) ndryshon si vijon:

- **Fuqinë në MW**
- **Sasinë e energjisë elektrike MWH**
- **Grafikun ditor të lëvrimit ;**
- **Kohëzgjatjen e lëvrimit në ditë/javë**
- **Periudhat e shkëmbimit (marrje – dhënie)**

➤ Në nenin 8, pika 1, paragrafi i parë ndryshon si vijon:

Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a i propozon Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë parashikimin për nevojën vjetore për shkëmbimet për situatat të paparashikuara.

➤ Në nenin 11, paragrafi i parë ndryshon si vijon:

KESH Sh.a modifikon grafikun « Muaj/Javë/Ditë në Avancë », sipas **Rregullave të Tregut** dhe ia paraqet OST Sh.a në përputhje me energjinë elektrike që do të shkëmbehet.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare